



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

I.AGJ.nr. 1/2023-82

Në bazë të nenit 3 dhe 4 të Rregullores për Procedurën e Rekrutimit të Praktikantëve në Gjykata, Gjykata Themelore në Prizren, shpall:

K O N K U R S
Nr.1/2023

Titulli i vendit të punës: Praktikantë

- 1.Gjykata Themelore në Prizren----- 25 pozita**
2.Gjykata Themelore në Prizren-Dega në Suharekë----- 10 pozita
3.Gjykata Themelore në Prizren-Dega në Dragash----- 5 pozita

Nënpunësi mbikqyrës: Administrator i Gjykatës-Ndihmës Administratori-në degë.

Kohëzgjatja e emërimit: Me afat të caktuar në kohëzgjatje prej një (1) viti (1 shkurt 2024 – 31 janar 2025).

Vendi: Gjykata Themelore në Prizren dhe deget e saja në Suharekë dhe Dragash.

Ne parim, gjatë periudhës së shërbimit të praktikës, praktikantët nuk do të kompensohen.

Perjashtimisht, në rast të sigurimit të mjeteve financiare qoftë nga buxheti i gjyqësorit apo nga ndonjë partner i KGJK-se, praktikantët mund të kompensohen.

(Rregullore nr. 8/2017 e datës 07 dhjetor 2017).

Përshkrimi i detyrave të punës:

Detyrat e Praktikantit: *Ndihmon zyrën e administratës në organizimin dhe ruajtjen e lëndëve, si dhe menaxhimin e tyre në përgjithësi.*

Detyrat kryesore:

- ❖ *Ndihmon punën në zyrën e administratës lidhur me organizimin dhe ruajtjen e lëndëve, si dhe në menaxhimin e tyre në përgjithësi.*
- ❖ *Ndihmon gjyqtarët në punët që kanë të bëjnë në futjen e lëndëve në dosje.*
- ❖ *Ndihmon në punën e zyrave të ndryshme në gjykatë, duke përfshirë regjistrimin, përpilimin e shkresave dhe ruajtjen e dosjeve.*
- ❖ *Kryen edhe pune tjera sipas nevojës.*

Kualifikimet:

- *Diplomë e Fakultetit Juridik, programi i studimeve (4) vjeçar apo 240 kredi ECTS ose Master.*
- *Njohuri të procedurave gjyqësore dhe ligjore.*
- *Aftësi të shkëlqyeshme për përpilimin me shkrim të drafteve juridike, duke përfshirë aftësinë në përpilimin e dokumenteve ligjore, si dhe shkathtësi komunikimi në të folur.*

VËREJTJE:

- *Procedura e konkursit është e hapur për kandidatë të jashtëm dhe nëpunës civil ekzistues.*
- *Procedura e rekrutimit zhvillohet sipas procedurave të parapara me Ligjin mbi Shërbimin Civil (Ligji Nr.03/L-149, dhe Rregullores për procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregullores për procedurën e rekrutimit të Praktikantëve (Rregullorja Nr. 02/2010).*
- *Kohëzgjatja e emërimit: **Me kohë të caktuar.***

Konkursi është publikuar më datën 20.12.2023 dhe mbyllet më datën 05.01.2024.

Aplikacionet mund t'i merrni në Zyrën e Pranimi në Gjykatën Themelore në Prizren, Rr. "William Walker", P.nr., dhe po ashtu, aplikacionet mund t'i shkarkoni në mënyrë elektronike në Web portalin e Këshilli Gjyqësor të Kosovës:

[Shkarko Aplikacionin](#)

Aplikacionin Aplikacionet e plotësuar mund t'i dorëzoni në Gjykatën Themelore në Prizren, Rr. "William Walker", P.nr.,

- *Shërbimi civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjitha personat e gjinisë mashkullore dhe femërore dhe nga të gjitha komunitetet në Kosovë.*
- *Komuniteti jo shumicë kanë të drejtë përfaqësimi proporcional në organet e Shërbimit civil të administratës publike, qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.*

Aplikacioni e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen për intervistë.

- **Të drejtë aplikimi kanë të gjithë banorët e Kosovës prej moshës 18-64 vjeçar. Aplikacionet duhet të plotësohen qartë dhe të lexueshëm. Në aplikacion duhet të shënohen të gjitha të dhënat e kërkuara. Duhet të plotësohet saktësisht vendi dhe pozita për të cilën aplikohet.**

Aplikacionit duhet të i bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për aplikim, si në vijim:

- *Diplomën e Fakultetit (të vlefshme në Republikën e Kosovës);*
- *Kopja e letërnjoftimit dhe*
- *Certifikatën nga evidenca penale të lëshuar nga Gjykata;*
- *Certifikata të tjera të tregojnë përgatitjen profesionale*

Nëse aplikacionit nuk ia bashkëngjitni dokumentet e duhura dhe nuk e plotësoni atë me shënime të sakta, aplikacionet nuk do të shqyrtohen. Fotokopjet e dokumenteve të bashkëngjitura në aplikacion, kandidatët nuk kanë të drejtë ti tërheqin mbrapa.

Në rast të ndonjë pyetje apo paqartësie mund të dërgoni pyetje në e-mailin:

gjthprizren@rks-gov.net